

VENDIM
Nr. 608, datë 30.7.2026

PËR RIORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT
KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 8, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar; të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 6 e 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (në vijim, IKMT-ja) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin/inspektimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e territorit, të mjedisit, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrjet e kundërligjshme të çdo lloji. IKMT-ja e ka selinë qendrore në Tiranë.

2. Misioni i IKMT-së është të sigurojë mbrojtjen e territorit, të mjedisit, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrjet e kundërligjshme të çdo lloji, nëpërmjet kontrollit/inspektimit, në përputhje me detyrat e përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 9, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. IKMT-ja është njësi shpenzuese më vete dhe financohet nga buxheti i shtetit e nga burime të tjera të ligjshme. Buxheti i IKMT-së përbën zë më vete në buxhetin e ministrisë përgjegjëse.

II. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

1. IKMT-ja e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në dy nivele:

a) Në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;

b) Në nivel rajonal, nëpërmjet 12 (dymbëdhjetë) drejtorive rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (në vijim, DRIKMT), si më poshtë vijon:

- i. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë;
- ii. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Durrës;
- iii. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Korçë;
- iv. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Vlorë;
- v. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Kukës;
- vi. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Shkodër;
- vii. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Berat;
- viii. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Dibër;
- ix. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Elbasan;
- x. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Fier;
- xi. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Lezhë;
- xii. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Gjirokastrë.

2. IKMT-ja drejtohet nga kryeinspektori qendror, i cili organizon e drejton veprimtarinë e institucionit, e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet e raporton për veprimtarinë inspektuese përpara ministrit përgjegjës dhe Inspektoratit të Përgjithshëm. DRIKMT-të drejtohen nga kryeinspektorët rajonalë.

3. Struktura dhe organika e IKMT-së miratohen nga Kryeministri, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin e funksionimit të administratës shtetërore. Përpara dërgimit të propozimit merret mendimi i detyrueshëm i Inspektoratit të Përgjithshëm, në përputhje me ligjin për inspektimin.

III. PËRGJEGJËSITË E KRYEINSPEKTORIT QENDROR E TË IKMT-së DHE DRIKMT-ve

1. Kryeinspektori qendror drejton veprimtarinë e IKMT-së dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

2. Kryeinspektori qendror është përgjegjës, për:

a) organizimin, koordinimin, funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së IKMT -së, nëpërmjet:

i. organizimit të punës për kryerjen e veprimtarisë inspektuese në secilën fushë inspektimi, me qëllim arritjen e përputhshmërisë ligjore nga subjektet e inspektimit;

ii. vlerësimit të performancës, përdorimit të burimeve të inspektimit dhe kuadrit institucional në tërësi, në raport me objektivat dhe nivelin e përmbushjes së treguesve, si dhe ndërmarrjes së nismave për përmirësimin e performancës;

iii. monitorimit e vlerësimit të efikasitetit të veprimtarisë inspektuese, sipas fushave të inspektimit dhe masave të ndërmarra për arritjen e objektivave;

iv. organizimit të punës dhe hartimit të dokumenteve për planifikimin, kryerjen dhe ndjekjen e inspektimeve;

v. zbatimit të politikave sektoriale, strategjive dhe programeve të inspektimit;

b) menaxhimin e burimeve njerëzore;

c) zbatimin dhe administrimin e buxhetit të miratuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në funksion të veprimtarisë së inspektoratit;

ç) nxjerrjen e akteve administrative të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për inspektimin dhe nga ligjet e posaçme;

d) zbatimin e ligjshmërisë në fushat që mbulon IKMT-ja, përfshirë mbrojtjen e territorit, të peizazhit, të mjedisit, të tokës, të ajrit, të ujërave, pyjeve, zonave të mbrojtura, produkteve të ndërtimit, menaxhimin e burimeve ujore dhe mbetjeve, nëpërmjet ushtrimit të kontrollit/inspektimit, sipas procedurave të parashikuara në ligjin për inspektimin dhe në ligjet e posaçme. Në rastet e lejeve të ndërtimit në kompetencë të KKTU-së, procesi i kontrollit dhe i monitorimit bashkërendohet me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e sekretariatit teknik të KKTU-së;

dh) raportimin e veprimtarisë inspektuese, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin;

e) nënshkruan vendimin përfundimtar të inspektimit, sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm, për marrjen e masave përkatëse dhe vendosjen e sanksioneve administrative, për procedurat e inspektimit të mbajtura nga struktura përgjegjëse inspektuese qendrore/rajonale.

3. IKMT-ja është përgjegjëse dhe ka për detyrë:

a) përcaktimin e objektivave për fushat e inspektimit, bazuar në politikat, strategjitë, programet dhe masat e hartuara nga ministritë përgjegjëse, si dhe identifikimin e treguesve kyç për vlerësimin e arritjes së këtyre objektivave;

b) hartimin e raportit vjetor për veprimtarinë inspektuese, i cili i paraqitet ministrit përgjegjës dhe Inspektoratit të Përgjithshëm, sipas rolit dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin për inspektimin;

c) marrjen e masave për parandalimin e risqeve, që mund të rezultojnë nga veprimtaria e subjekteve të inspektimit në fushat nën juridiksionin e tij;

ç) kryerjen e vlerësimeve në rastet e dëmit të shkaktuar nga veprimtari të ndryshme në fushën e pyjeve, sipas ligjit të posaçëm;

d) marrëdhëniet me publikun dhe ndërgjegjësimin publik, nëpërmjet këshillimit dhe informimit të subjekteve për detyrimet ligjore, që duhet të respektojnë;

dh) drejtimin e bashkërendimin e punës për gjenerimin, grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave cilësore e sasiore në fushat e inspektimit që mbulon;

e) propozimin e metodave, të teknikave inovative ose të ndryshimeve ligjore, që kontribuojnë në rritjen e eficiencës së veprimtarisë inspektuese;

ë) bashkëpunimin e bashkërendimin e punës me institucione analoge vendase ose të huaja, në fushat që mbulon;

f) vlerësimin dhe evidentimin e nevojave për trajnimin e inspektorëve, në bashkëpunim me Inspektoratin e Përgjithshëm dhe me institucione të tjera vendase ose të huaja;

g) hartimin e programeve vjetore dhe mujore të inspektimit, bazuar në metodologjinë e vlerësimit të riskut, në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin dhe të legjislacionit të posaçëm;

gj) zbatimin e programit të inspektimit, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

h) kryerjen e inspektimeve mbi bazën e planeve vjetore/mujore dhe të vlerësimit të riskut, me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë së ligjit në fushat që mbulon IKMT-ja;

i) monitorimin e kontrollin e veprimtarisë së strukturave inspektuese të drejtorive rajonale të IKMT-së dhe ato pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas fushave përkatëse të inspektimit, si dhe marrjen e masave e të sanksioneve në rastet kur evidentohen shkelje, sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm dhe të ligjit për inspektimin;

j) nëpërmjet trupës inspektuese, marrjen e masave për përcjelljen dhe referimin e kallëzimit penal pranë organeve kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, duke vënë në dispozicion materialet dhe informacionin e disponuar.

4. Kryeinspektori rajonal dhe drejtorja rajonale e IKMT-së ushtrojnë këto përgjegjësi dhe detyra:

a) Mbledhin, përpunojnë dhe analizojnë të dhëna e informacione, të cilat ia raportojnë drejtorisë qendrore;

b) Kryejnë inspektime mbi bazën e planeve vjetore/mujore dhe të vlerësimit të riskut, me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë së ligjit në fushat që mbulon IKMT-ja;

c) Bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse në njësitë e vetëqeverisjes vendore, Policinë e Shtetit dhe agjenci të tjera shtetërore, sipas legjislacionit për inspektimin dhe ligjit të posaçëm;

ç) Evidentojnë nevojat për trajnimin e inspektorëve, me qëllim ushtrimin efektiv të përgjegjësisë dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në fushën përkatëse të inspektimit;

d) Për procedurat e inspektimit të mbajtura nga struktura përgjegjëse inspektuese rajonale, vendimi përfundimtar i inspektimit nënshkruhet nga kryeinspektori qendror, sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm;

dh) Nëpërmjet trupës inspektuese, marrjen e masave për përcjelljen dhe referimin e kallëzimit penal pranë organeve kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, duke vënë në dispozicion materialet dhe informacionin e disponuar.

IV. MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

1. Marrëdhëniet e punës së inspektorëve të IKMT-së dhe DRIKMT-ve rregullohen sipas Kodit të Punës, ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjeve të posaçme sektoriale dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre, përfshirë rregullat për kriteret e emërimit, ushtrimin e funksionit inspektues, trajnimin dhe certifikimin, kur këto kërkojnë nga legjislacioni në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

2. Rregullorja e brendshme e IKMT-së miratohet nga ministri përgjegjës, me propozimin e kryeinspektorit qendror.

3. IKMT-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e IKMT-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit”, në përputhje me përcaktimet e

vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

4. DRIKMT-të kanë stemën, logon dhe vulën e tyre zyrtare. Stema e DRIKMT-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale e IKMT-së (emri i qarkut, ku ka selinë drejtoria rajonale)”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

5. Vula e IKMT-së dhe vulat e secilës DRIKMT kanë formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen e ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Strukturat përgjegjëse të IKMT-së, AKM-së dhe AKZM-së vijnë të përmbushin përgjegjësitë e tyre deri në funksionimin e plotë të IKMT-së dhe DRIKMT-ve, me qëllim garantimin e vijimësisë institucionale, administrative e procedurale, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi.

2. Pozicionet që ushtrojnë funksione inspektuese në inspektoratin qendror dhe në drejtoritë rajonale përcaktohen në strukturën dhe organikën e miratuar, në përputhje me ligjin për inspektimin, ligjet e posaçme dhe aktet nënligjore në fuqi, dhe përfshijnë:

- a) kryeinspektor qendror;
- b) kryeinspektor i drejtorisë rajonale;
- c) drejtor drejtorie në drejtorinë qendrore ose rajonale;
- ç) përgjegjës sektori në drejtorinë qendrore ose rajonale;
- d) inspektor në drejtorinë qendrore ose rajonale.

3. Punonjësit, fondet buxhetore, dokumentacioni, arkivat, dosjet në proces, mjetet, pajisjet dhe asetet e tjera të strukturave përgjegjëse me funksione inspektuese pranë AKM-së dhe AKZM-së, pas riorganizimit në zbatim të këtij vendimi dhe ligjit për inspektimin, i kalojnë IKMT-së dhe DRIKMT-ve, sipas akteve të dorëzimit dhe legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar, buxhetor dhe administrimin e pasurisë publike.

4. Strukturat përgjegjëse të IKMT-së, AKM-së dhe AKZM-së kanë një afat prej 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi për të përmbyllur procesin e riorganizimit të tyre, përfshirë transferimin e dosjeve, të arkivave, të mjeteve, të pajisjeve, të aseteve, të të drejtave dhe detyrimeve administrative, që lidhen me funksionet që u kalojnë IKMT-së dhe DRIKMT-ve.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

6. Vendimi nr. 893, datë 4.11.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mjedisit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Inspektorati i Përgjithshëm, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama